

ISSN: 2521-831X

Volumi / Volume Nr.5

Numri / Issue 57

SHTATOR/SEPTEMBER - 2021

**BULETINI
M U J O R
KLIMATIK**

**CLIMATE
MONTHLY
BULLETIN**

UPT – IGEO

Departamenti i Meteorologjisë

PUT – IGEO

Department of Meteorology



Tirana, Albania © 2021

8 SEPTEMBER
TEMPERATURE
2021



28.6°C

**DRAMMEN,
NORWAY**

HIGHEST SEPTEMBER TEMPERATURE ON RECORD

°C

Graphic by: @SCOTTDUNCANWX

-20 -15 -10 -5 0 5 10 15 20 25 30 35 40 45 50


DATA: GFS 0.25°

Run: 06/09/21 00 UTC

UPT



IGEO





UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE
Departamenti i Meteorologjisë

Adresa: Rruga "Don Bosko", Nr.60, Tiranë, Tel/Fax: +355 42250601 www: www.geo.edu.al

Viti i 5^{të} i botimit / The 5th year of issues UPT-IGEO / PUT-IGEO  Klima.Shqiperia@gmail.com

BULETINI MUJOR KLIMATIK CLIMATE MONTHLY BULLETIN

SHTATOR / SEPTEMBER 2021


Nr.57

Përmbledhje. Muaji shtator 2021 si në shkallë europiane ashtu dhe për Shqipërinë përcolli mot të qendrueshëm dhe me temperatura më të larta se norma me rreth $+1.7^{\circ}\text{C}$, ku anomalitë më të larta me $+2.6^{\circ}\text{C}$ i shënuan temperaturat maksimale të ajrit. Nuk munguan dhe netët tropikale, të cilat nuk kanë qenë më parë karakteristike për këtë muaj. Reshjet shënuan një ulje të theksuar në territorin e Shqipërisë ku vlerat e tyre mujore në shkallë vendi ishin pothuajse sa gjysma e vlerave të normës. Natyrisht ato u vrojtuan dhe në numër ditësh më të vogël se norma me rreth -42% . Një vëmendje e veçantë i kushtohet ndryshimeve klimatike sipas modeleve të ndryshme në shkallë europiane, vlerësimeve të bëra për Shqipërinë në këto 5 vitet e fundit si dhe natyrisht dhe për situatën e muajit shtator 2021. Në vijim jepet një vlerësim agrometeorogjik për situatën e motit në këndvështrimin bujqësor që karakterizoi muajin shtator 2021; një artikull shkencor mbi reshjet e muajit janar 2021, të cilat përrollën dhe përmyje në Shqipëri si dhe në fund në rubrikën e informacioneve shkencore përmyllet me disa të dhëna fiziko-geografike, klimatike dhe hidrografike të lumit Erzen.

Summary. The month of September 2021, both on a European scale and for Albania, conveyed stable weather and with temperatures higher than the norm by about $+1.7^{\circ}\text{C}$, where the highest anomalies with $+2.6^{\circ}\text{C}$ marked the maximum air temperatures. There were also tropical nights, which have not been characteristic for this month before. Rainfall marked a significant decrease in the territory of Albania where their monthly values nationwide were almost half of the norm. Of course, they were observed in a number of days less than the norm by about -42% . Special attention is paid to climate change according to different models at European level, assessments made for Albania in the last 5 years and of course for the situation of September 2021. The following is an agrometeorological assessment of the weather situation from agricultural view point of view, that characterized the month of September 2021. A scientific article on the rainfall of January 2021, which provided also floodings in Albania and finally in the section of scientific information some physical-geographical, climatic and hydrographic data of the river Erzen conclude this bulletin.

TABELA E PËRMBAJTJES / TABLE OF CONTENT

Përmbledhje	3	Summary.	Error! Bookmark not defined.
Hyrje	5	Introduction	5
Temperaturat e ajrit.....	6	Air temperatures.....	6
Reshjet atmosferike.....	14	Atmospheric precipitation	Error! Bookmark not defined.
Agrometeorologji.....	23	Agrometeorology.	23
Energjitë e rinovueshme.	26	Renewable energies.....	26
Ndryshimet Klimatike.....	27	Climate change.....	27
Artikull shkencor.....	33	Scientific Article.....	33
Informacione shkencore.....	36	Scientific information	36



Muaji shtator 2021 u dallua si në shkallë kontinentale ashtu dhe për vendin tonë për temperatura të larta, të cilat përcollën një stinë të tejzgjatur të verës. Muaji shtator 2021 u rendit pas muajit më “të nxehtë” gushtit, duke e kthyer verën në një stinë me “4 muaj”.

The month of September 2021 was distinguished both on a continental scale and for our country for high temperatures, which followed a prolonged summer season. September 2021 was ranked after the "hottest" month of August, turning summer into a "4 month" season.

Muaji shtator 2021 ngjasoj më shumë si pjesë e stinës së verës sesa asaj të vjeshtës. Në këtë muaj shënohet dhe ekuinoksi i vjeshtës, ku vrojtohet dhe momenti i kohëzgjatjes së barabartë të periudhës me ndriçim me datën 22 shtator, që pasohet në vijim me një natë më të gjatë se sa dita. Duhet thënë se kjo datë ndryshon ndër vite për shkak të korrektimeve që bëhen në lidhje me vitin e brishtë, ku për shekullin XXI kjo datë do të vrojtohet me vonë me 23 shtator 2096 dhe me herët është vrojtuar me datë 21 shtator 2003.

The month of September 2021 resembles more as part of the summer season than that of autumn. In this month is also marked the autumnal equinox, where the moment of equal duration of day-night is observed on September 22, which is followed by a night longer than the day. It should be noted that this date varies over the years due to corrections made in relation to the leap year, where for the XXI century this date will be observed later on 23 September 2096 and earlier it was observed on 21 September 2003.




Figure Nr.1. - Vlerat e temperaturave maksimale të ajrit për kontinentin Europian në datën 7 shtator 2021, sipas Copernicus. / Values of maximal air temperatures for European continent on date September 7, 2021, according to Copernicus.

Në figurën Nr.1 paraqitet harta e kontinentit Europian për datën 7 shtator 2021 në mesditë, një ndër ditët më të nxehta të këtij muaji. Një stinë verë me "4 muaj" do të ishte përshkrimi më i mirë për shtatorin 2021. Kjo rezultatit i mbizotërimit të pranishë së masave ajrore të ngrohta dhe fushave me presion të lartë atmosferik që kushtëzuan dhe një numër ditësh e të ulët me vranësirë dhe reshje dhe për rrjedhojë dhe më shumë orë me diell dhe temperaturave më të larta, të cilat ishin të pranishme dhe në hapësirën e Shqipërisë.

Figure No.1 shows the map of the European continent for September 7, 2021 at noon, one of the hottest days of this month. A summer season with "4 months" would be the best description for September 2021. This is the result of the predominance of the presence of warm air masses and areas with high atmospheric pressure that conditioned and a number of low days with cloudiness and precipitation as well as consequently hours of sunshine and higher temperatures, which were present in the area of Albania.

Temperaturat e ajrit përgjatë muajit shtator 2021 ishin një tejzgjatje e stinës së verës. Në shkallë globale dhe për kontinentin Europian kjo situatë paraqitet në figuren Nr.2. në mënyrë më të detajuar vlerat e temperaturave mesatare dhe anomalitë e tyre për Europën jepen në hartat e dhëna në figurën Nr.3.



Air temperatures during September 2021 were an extension of the summer season. Globally and for the European continent this situation is presented in figure No.2 in down scale the values of average temperatures and their anomalies for Europe are given in the maps given in figure No.3.




Figure Nr.2 - Anomalitë e temperaturës së ajrit pranë sipërfaqes për muajin shtator 2021 kundrejt periudhës 1991÷2020. / Surface air temperature anomaly for September 2021 compare to the period 1991÷2020 (Copernicus, ECMWF, etc.).




Figure Nr.3. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit dhe anomalive të tyre për kontinentin Europian për muajin shtator 2021, sipas NOAA-s. / Values of mean air temperatures and their anomalies for the European continent for the month of September 2021, according to NOAA.

Në shkallë kontinentale shtatori 2021 shënoi vlera rekord nga pikëpamja historike dhe prania e valëve të të nxehtit. Me date 8 shtator 2021 u shënuan vlera rekord prej +28.6°C në Drammen të Norvegjisë, e pa vërtetuar më parë në këto gjerësi gjeografike veriore të Europës. Muaji shtator 2021 për Shqipërinë erdhi në vijim të muajt gusht si muaji më “i nxehtë” i vërtetuar jo vetëm gjatë viteve të fundit, por edhe këtë vit.

On a continental scale September 2021 marked record values from a historical point of view and presence of heat waves. On September 8, 2021, a record value of +28.6°C was recorded in Drammen, Norway, not previously observed in these northern latitudes of Europe. September 2021 for Albania came after August as the "hottest" month observed not only in recent years, but also this year.

Në shkallë vendi referuar temperaturave mesatare të ajrit u shënua një anomali prej $+1.7^{\circ}\text{C}$. Në figurën Nr.4 paraqiten grafikisht të dhënat e temperaturave mesatare të ajrit për disa vendmatje meteorologjike për muajin shtator 2021, që i përket zonave të ndryshme klimatike.

Nationwide, referring to the average air temperatures, an anomaly of $+1.7^{\circ}\text{C}$ was recorded. Figure No.4 graphically presents the data of average air temperatures for some meteorological stations for the month of September 2021, which belong to different climatic zones





Figure Nr.4. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit shtator 2021 për Shqipërinë. / Values of mean air temperatures for some meteorological stations of September month 2021 for Albania.

Në figurën Nr.6 sipas jave të ndryshme të muajit shtator 2021 paraqitet situata e temperaturave mesatare të ajrit në shkallë kontinentale. Një informacion më i detajuar për ecurinë ditore të temperaturave dhe reshjeve për 12 vendmatje meteorologjike është dhënë në vijim në grafikët e parqitur në figurën Nr.7. Ndërkohë me interes paraqitet dhe informacioni se si ka qenë ecuria e temperaturave mesatare mujore të ajrit në shkallë vendi nga muaji janar deri në shtator 2021 për Shqipërinë, e cila grafikisht është pasqyruar në figurën Nr.5, ku dukshëm eidentohen anomali të theksuara kundrejt vlerave të normës për muajt e verës si dhe ajo për muajin gusht me vlerat më të larta $+3.6^{\circ}\text{C}$ dhe e muajit shtator 2021 me $+1.7^{\circ}\text{C}$. Në faqen 2 të këtij buletini pasqyrohet dhe vlera mesatare e anomali të 5 viteve të fundit për vendin tonë, ku eidentohet dhe “tejzgjatja” e qartë e stinës së verës sa i takon ecurisë së temperaturave të ajrit.

Figure No.6 according to the different weeks of September 2021 shows the situation of average air temperatures on a continental scale. A more detailed information on the daily performance of temperatures and precipitation for 12 meteorological measurements is given below in the graphs shown in figure No.7. Meanwhile, the information on the performance of the average monthly air temperatures nationwide from January to September 2021 for Albania, which is graphically reflected in Figure No.5, where the pronounced anomalies against the values of rate for the summer months as well as that for the month of August with the highest values $+3.6^{\circ}\text{C}$ and of the month of September 2021 with $+1.7^{\circ}\text{C}$. In the page nr. 2 of this bulletin its shown the average value of anomalies of the last 5 years for our country, which shows the clear "excess" of the summer season in terms of air temperatures.

Figure Nr.5. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit dhe anomali në shkallë vendi për muajt janar ÷ shtator 2021 për Shqipërinë si dhe vlerat e normës 1961÷1990. / Values of mean air temperatures and anomalies for Albania for the months January to September 2021 and norm values of the period 1961÷1990.







Figure Nr.6. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për kontinentin European për 5 javët e muajit shtator 2021, sipas NOAA-s. / Average values of air temperatures for European Continent for the 5 weeks of September 2021, according to NOAA.

Figure Nr. 7/1÷7/12 - Temperaturat ditore për disa vendmatje meteorologjike për muajin shtator 2021 në Shqipëri.
The daily temperatures for some meteorological stations for September month 2021 in Albania.






Figura Nr.8. - Vlerat e temperaturave maksimale ekstreme të ajrit për kontinentin European për 5 javët e muajit shtator 2021, sipas NOAA-s. / Extreme maximal values of air temperatures for European Continent for the 5 weeks of September 2021, according to NOAA.

Vlerat më të larta i shënuan temperaturat maksimale të ajrit, të cilat në shkallë kontinentale sa i takon javëve të ndryshme të muajit shtator 2021 paraqiten në figurën Nr.8. Ndërkohë për vendin tonë një tablo e tyre parqitet grafikisht për disa vendmatje meteorologjike në grafikun e figurës Nr.9.

The highest values marked the maximum air temperatures, which on a continental scale with respect to the different weeks of September 2021 are presented in Figure No.8. Meanwhile, for our country, a picture of them is presented graphically for some meteorological stations in the graph of figure No.9




Figura Nr.9. - Vlerat e temperaturave mesatare maksimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit shtator 2021 për Shqipërinë. / Values of mean maximal air temperatures for some meteorological stations of September month 2021 for Albania.

Me mjaft interes të evidentohen për këtë situatë meteorologjike që karakterizoi motin gjatë muajit shtator janë dhe vlerat e temperaturave maksimale të ajrit, të cilat ndonëse nuk thyen rekordet historike arritën vlera mjaft të larta. Ato pasqyrohen grafikisht në figurën Nr.10 për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë.

Of great interest to be evidenced for this meteorological situation that characterized the weather during September are the values of maximum air temperatures, which although did not break the historical records reached quite high values. They are graphically reflected in figure No.10 for some meteorological stations of Albania




Figura Nr.10. - Vlerat e temperaturave maksimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit shtator 2021 për Shqipërinë. / Values of maximal absolute air temperatures for some meteorological stations of September month 2021 for Albania.

Veçanërisht për muajin shtator 2021 është e rëndësishme të paraqitet ecuria e vlerave të temperaturave minimale të ajrit, të cilat jo vetëm që ishin mbi vlerat e normës me (+0.7°C), por në mjaft vendmatje gjatë natës u shënuan vlera mbi pragu 20.0°C, që nënkupton dhe praninë e një sërë netësh tropikale, të cilat nuk kanë qenë më parë karakteristike e klimës së këtij muaji (shih dhe tabelën Nr.1).

Especially for September 2021 it is important to present the performance of the values of minimum air temperatures, which were not only above the norm values by (+ 0.7°C), but in many measurements at night were recorded values above the threshold of 20.0°C, which also means the presence of a series of tropical nights, which have not been previously characteristic of this month's climate (see also table No.1).

Në vijim në figurën Nr.11 paraqiten të dhënat e temperaturave mesatare minimale të ajrit të muajit shtator 2021 për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë, ndërsa të dhënat mbi vlerat minimale absolute pasqyrohen në grafikun e dhënë në figurën Nr.12.

The following in figure No.11 are presented the data of the average minimum air temperatures of September 2021 for some meteorological measurements of Albania, while the data on the absolute minimum values are reflected in the graph given in figure No.12.




Figura Nr.11. - Vlerat e temperaturave mesatare minimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit shtator 2021 për Shqipërinë. / Values of mean minimal air temperatures for some meteorological stations of September month 2021 for Albania.




Figura Nr.12. - Vlerat e temperaturave minimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit shtator 2021 për Shqipërinë. / Values of minimal absolute air temperatures for some meteorological stations of September month 2021 for Albania.

Në shkallë kontinentale të dhënat e temperaturave mesatare minimale extreme për muajin shtator 2021 paraqiten në figurën Nr.13.

On a continental scale, the data of the minimum average extreme temperatures for the month of September 2021 are presented in figure No.13.

Table Nr.1. – Numri netëve tropikale gjatë muajit shtator 2021 për disa vendmatje meteorologjike për Shqipërinë. / The number of tropical nights for some meteorological stations during September 2021 for Albania.

Vendmatja meteorologjike Meteorological stations	Numri i netëve Night number
Brataj	3
Bushat	1
Çukë	1
Konispol	8
Krujë	2
Orikum	3
Prrenjas	1
Tiranë	5
Ura e Shtrenjtë	2




Figura Nr.13. - Vlerat e temperaturave minimale ekstreme të ajrit për kontinentin Europian për 5 javët e muajit shtator 2021, sipas NOAA-s. / Extreme minimal values of air temperatures for European Continent for the 5 weeks of September 2021, according to NOAA.

Reshjet atmosferike gjatë muajit shtator 2021 shënuan vlera të ulta pothuajse në mbarë kontinentin European, siç tregohet dhe në hartat e figurës Nr.14, ku përjashtim bëri kryesisht gadishulli Iberik, një pjesë e Francës si dhe Europa VL. Reshjet e vërtetuara në territorin e Shqipërisë ishin rreth gjysma e vlerave të normës, të cilat grafikisht për një sërë vendmatjesh meteorologjike të zonave dhe nënzonave të ndryshme klimatike paraqiten në grafikun e dhënë në figurën Nr.15.



Atmospheric precipitation during September 2021, are recorded low values almost throughout the European continent, as shown in the maps of figure No.14, with the exception of the Iberian Peninsula, a part of France and Europe VL.

The precipitations observed in the territory of Albania were about half of the norm values, which graphically for a series of meteorological stations of different climatic zones and sub-zones are presented in the graph given in figure no.15.




Figura Nr.14. - Reshjet për muajin shtator 2021 në kontinentin European dhe anomalitë kundrejt periudhës 1981÷2010, sipas NOAA-s. / Rainfall for September 2021 at the European continent and their anomalies referring to the period 1981÷2010 according to NOAA.






Figura Nr.15. – Lartësia e reshjeve për disa vendmatje meteorologjike të muajit shtator 2021 për Shqipërinë. / The amount of precipitations for some meteorological stations of September month 2021 for Albania.

Natyrshisht reshjet më të pakta u vërtetuan dhe një numër ditësh me reshje më të ulët se vlerat e mesatares shumëvjeçare. Në figurën Nr.16 paraqitet grafiku i këtij treguesi ku vlerat tregojnë një anomali prej -42% më pak se norma në shkallë vendi.

Naturally less rainfall was observed and a number of days with rainfall lower than the multi-year average values. Figure No.16 shows the graph of this indicator where the values show an anomaly of -42% less than the rate nationwide.



Për situatën e shpërndarjes së reshjeve, lagështisë relative të ajrit, të tokës etj., të muajit shtator 2021 në shkallë kontinentale në figurën Nr.17 dhe Nr.18 jepen disa të dhëna më të detajuara. Ndërsa situata e shpërndarjes së reshjeve mbi territorin e Shqipërisë pasqyrohet në hartën e figurës Nr.22., ku ndonëse ato në tërësinë e tyre ishin nën normë, pjesa VL shënon vlera më të larta. Anomali të në shkallë kontinentale jepen në figurën Nr.21.

For the situation of distribution of precipitation, relative humidity of air, soil, etc., of the month September 2021 on a continental scale in figure Nr.17 and Nr.18 are given some more detailed data. While the situation of rainfall distribution over the territory of Albania is reflected in the map of figure No.22, where although they in their entirety were below the norm, part VL marks higher values. Continental-scale anomalies are given in Figure No.21.




Figura Nr.18. – Reshjet në % kundrejt vlerave të normës për muajin shtator 2021 për kontinentin European. / The precipitations for September month 2021 compare to norm values for European continent in %.




Figura Nr.19. – Numri i ditëve me reshjeve mbi pragun 10.0 mm për disa vendmatje meteorologjike për muajin shtator 2021 për Shqipërinë. / The number of days with precipitations over the threshold 10.0 mm for some meteorological stations of September month 2021 for Albania.

Treguesit e numrit të ditëve me reshje mbi pragun 10.0 mm për disa vendmatje meteorologjike paraqiten në grafikun e dhënë në figurën Nr.19, ndërsa reshjet maksimale 24 orëshe jepen në figurën Nr.20.

Indicators of the number of days with rainfall above the threshold 10.0 mm for some meteorological stations are presented in the graph show in figure No.19, while the maximum 24-hour rainfall is show in figure No.20.




Figura Nr.20. - Reshjet maksimale 24 orëshe për muajin shtator 2021 në disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë. / Maximal 24 hours rainfall for the month of September 2021 at some meteorological stations f Albania.






Figura Nr.21. – Anomalite e reshjeve në mm kundrejt vlerave të normës për muajin shtator 2021 për kontinentin European. / The precipitations anomalies in mm for September month 2021 compare to norm values for European continent.



Anomalitë e reshjeve për muajin shtator 2021 tregojnë për një situatë deficitare në hapsirën e Ballkanit dhe në veçanti dhe në vendin tonë. Në hartën e dhënë në figurën Nr.23 pasqyrohen anomalitë e reshjeve për Shqipërinë, ndërsa në figurën Nr.24 paraqiten të dhënat e numrit të ditëve me reshje.




Reshjet dhe percentilet. Një mënyrë tjetër për të përcaktuar thatësinë janë percentilet. Një percentile është vlera e një ndryshoreje nën të cilën bien një përqindje e caktuar e vëzhgimeve. Seria afatgjatë e reshjeve është renditur sipas muajve duke përdorur një periudhë 50 vjeçare (1951÷2000). Përqindja e 5-të (10, 15 etj.) është vlera nën të cilën mund të gjenden 5 (10, 15 etj.) përqindje vëzhgimeve. Percentili i 25-të njihet edhe si kuartil i parë; përqindja e 50-të si mesatare. Vlerat e përqindjes mbi 50 tregojnë periudha më të lagështa dhe vlerat më të vogla se 50 tregojnë periudha më të thata.

Situata e reshjeve për Ballkanin paraqitet në hartën e dhënë në figurën nr.25, sëbashku me shpërndarja e vlerave të percentileve.

Rainfall anomalies for September 2021 indicate a deficit situation in the Balkans and in particular in our country.

The map given in figure No.23 reflects the precipitation anomalies for Albania, while figure No.24 shows the data of the number of rainy days.



Precipitation and percentiles Another way to define drought are percentiles. A percentile is the value of a variable below which a certain percent of observations falls. Long term precipitation record is sort by rank by month; 50 years period (1951÷2000) was used. The 5th (10th, 15th etc.) percentile is the value below which 5 (10, 15 etc.) percent of the observations may be found. The 25th percentile is also known as the first quartile; the 50th percentile as the median. Percentile values above 50 indicate wetter periods and values less than 50 indicate drier periods.

The precipitation situation for the Balkans is presented in the map given in figure no.25, together with the distribution of percentile values.




Figura Nr.25. – Vlerat e reshjeve (në mm) (majtas) dhe te percentileve (djathtas) për gadishullin Ballkanit për muajin shtator 2021. / The values of precipitation (in mm) (on the left) and percentiles (on the right) for Balkan peninsula for the month of September 2021.

Natyrisht gjatë muajit shtator 2021 në vendin tonë nuk munguan dhe ditët me vranësira, të cilat ishin më të intensifikuara në javën e fundit. Për ilustrim në vijim në figurat Nr.26, Nr.27 & Nr. 28., jepen pamje të vranësirës në datën 1, 8, 12 shtator 2021. Ndërkohë për situatën e veçantë të reshjeve të datës 19 shtator 2021 në figurën Nr.29 paraqitet shpërndarja e tyre në hapësirë në Shqipëri, ku siç shihet ato ishin mbizotëruese në pjesën veriore të vendit. Figura Nr.30 pasqyron reshjet maksimale 24 orëshe në Shqipëri për muajin shtator 2021.

Of course, during the month of September 2021 in our country there were also cloudy days, which were more intensified in the last week. For the following illustration in figures No.26, No.27 & No. 28 are given images of eclipses on 1, 8, 12 September 2021. Meanwhile, for the special situation of precipitation on 19 September 2021, figure No.29 shows their distribution in space in Albania, where as can be seen they were predominant in the northern part of country. Figure No.30 reflects the maximum 24-hour rainfall in Albania for September 2021.

Figura Nr.26. – Pamje e malit të Tomorrit nga Kozarë, në datë 1 shtator 2021, Kuçovë, Shqipëri. / View of Mountain Tomor from Kozare on date September 1, 2021, Kuçovë, Albania (photo: G. Çela).



Figure Nr.27. - Pamje e situatës me vranësira dhe dukurinë e ylberit me datë 8 shtator 2021 ora 18:41 në Tiranë. View of cloudiness and rainbow phenomena in Tirana on hour 18:41 date September 8, 2021 (photo: P. Zorba).

Figure Nr.28 – Pamje e situatës me vranësira me datë 12.09.2021 11:34 Ardenicë, Lushnjë, pjesa qendrore e Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë. / View of cloudiness on date 12.09.2021 11:34 at Ardenice, Lushnje, part of central part of Western Lowland of Albania (Photo: P. Zorba).




Figura Nr.29. – Reshjet 24 orëshe (në mm) për datën 19 shtator 2021 Shqipërinë.
 The 24 hour precipitation for Albania on date September 19, 2021.




Figura Nr.30. – Reshjet maksimale 24 orëshe (në mm) për Shqipërinë për muajin shtator 2021.
 The Maximal 24 hour precipitation for Albania for September 2021.

Në procesin e rianalizës së të dhënave ose situatave të veçanta të motit një vlerë të rëndësishme kanë dhe të dhënat mbi parashikimin 24 orësh të reshjeve, të cilat ndihmojnë në saktësimin hapësinor ose kohor të vlerësimeve të ndryshme meteorologjike.

In the process of re-analyzing data or specific weather situations, data on 24-hour rainfall forecasting have an important value, which help in spatial or temporal accuracy of various meteorological estimates.




Figura Nr.31. – Vlerësimi i reshjeve të pritshme çdo ditë, për 24 orët në vijim sipas platformës “SEEFFG” për muajin shtator 2021. / The estimation for the expected precipitation on the next 24 hours according to the platform “SEEFFG” for September month 2021.

Të dhënat mbi reshjet e parashikuara 24 orëshe janë një informacion i rëndësishëm për të ri-analizuar situatën mbizotëruese me reshje për muajin shtator 2021, të cilat sipas produkteve të platformës SEEFFG, janë paraqitur në figurën Nr.31.

The forecast data on 24-hour precipitation is an important information to re-analyze the prevailing precipitation situation for September 2021, which according to the products of the SEEFFG platform, are presented in Figure No.31.

Agrometeorologji. Gjatë muajit shtator 2021 moti me temperatura të larta dhe krysisht pa reshje u paraqit favorizues për fazat përmbyllëse të ciklit të mjaft kulturave bujqësore. Për më tepër ai u paraqit pozitivisht dhe në këndvështrimin e një tejzgjatje të periudhës së vegetacionit ashtu siç ka ndodhur dhe në vitet e fundit, duke mundësuar një potencial prodhues më të lartë dhe mundësi kultivimi për bimët me cikël më të gjatë vegetativ.



Agrometeorology. During the month of September 2021, the weather with high temperatures and mainly without rain appearing favorable for the closing phases of the cycle of many agricultural crops. Moreover, it appeared positively in terms of an extension of the vegetation period as it has happened in recent years, enabling a higher productive potential and cultivation opportunities for plants with longer vegetative cycles.




Figure Nr.32. – Treguesi i shumës së temperaturave aktive të ajrit mbi pragu 10°C për muajin shtator 2021 në disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë. / The index of the sum of active air temperatures above the threshold 10°C for September month 2021 at some meteorological stations of Albania.

Treguesi i shumës së temperaturave aktive mbi pragu 10°C shënoi vlera të larta dhe në përgjithësi mbi normë. Një informacion i tillë më i detajuar është paraqitur në grafikun e dhënë në figurën Nr.x.

The index of the sum of active temperatures above the threshold of 10°C marked high values and averaging above the norm values. Such a more detailed information is presented in the graph shown in figure No.x.




Figura Nr.33. – Vlerat e përlllogaritura të avullimit për muajin shtator 2021 për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë. / The calculated values of evaporation for September month 2021 for some meteorological stations of Albania.

SPI Një nga treguesit më të rëndësishëm të thatësisrës është i Treguesi i Standardizuar i Reshjeve (SPI). Ky mund të llogaritet në shkallë të ndryshme kohore, të cilat pasqyrojnë ndikimin e thatësisrës në disponueshmërinë e burimeve ujore. Llogaritja e SPI bazohet në shpërndarjen e reshjeve në periudha të gjata kohore (është përdorur 30 vjet (1961-1990). Regjistrimi afatgjatë i reshjeve përshtatet me një shpërndarje probabiliteti, e cila më pas normalizohet në mënyrë që SPI mesatare për çdo vend dhe periudhë kohore të jetë zero. Vlerat SPI mbi zero tregojnë periudha më të lagështa dhe vlerat më të vogla se 0 tregojnë periudha më të thata. Mungesa e reshjeve dhe niveli i lartë i avullimit pasqyrohet dhe në rënien e nivelit të ujëmbledhësve. Për ilustrim shih dhe figurën Nr.35.

SPI One of the most robust drought indices is so called Standardized Precipitation Index (SPI). The SPI can be calculated at various time scales which reflect the impact of the drought on the availability of water resources. The SPI calculation is based on the distribution of precipitation over long time periods (30 years (1961-1990) was used). The long-term precipitation record is fit to a probability distribution, which is then normalized so that the mean (average) SPI for any place and time period is zero. SPI values above zero indicate wetter periods and values less than 0 indicate drier periods.

Lack of precipitation and high level of evaporation is also reflected in the decrease of catchment levels. For illustration see also figure No.35.




Figure Nr.34. - Treguesi i thatesires (SPI) për muajin shtator 2021 (majtas) per gadishullin e Ballkanit dhe per periudhen e tre muajve te fundit (djathtas). / Drought Index (SPI) for September 2021 (left) for the Balkan Peninsula and for the last three months (right).





Figura Nr.35. – Pamje nga liqeni i Treganit në rrethin e Elbasanit ku evidentohet një rënie e nivelit të ujit. / View of Tregan lake on the Elbasan region where is evidenced a lower of water level (photo: G. Çela).



Ndërkohë treguesi i vegjetacionit NDVI përgjatë muajit shtator 2021 ruajti nivele të larta, ashtu siç kjo duket qartë dhe në figurën Nr.36 nëpërmjet disa pamjeve satelitore për territorin e Shqipërisë sipas javëve të ndryshme. Gjithësesi për ato zona ku vegjetacionit po i vjen fundi aktiv për këtë vit lehtësisht shënohen vlera në ulje.

Meanwhile, the vegetation index NDVI during September 2021 maintained high levels, as it is clearly seen in figure No.36 through some satellite images for the territory of Albania according to different weeks. However, for those areas where the vegetation is coming to an active end for this year, values are easily reduced.

Energjitë e rinovueshme.

Biomasa në thelb është një burim i ruajtur/konservuar i energjisë diellore, e cila mbledhet fillimisht nga bimët gjatë procesit të fotosintezës, ku dioksidi i karbonit kapet dhe shndërrohet në produkt bimor kryesisht në formën e celulozës, gjysmëcelulozës dhe linjinës. Biomasa është lëndë e parë nga e cila mund të përftojme njëkohësisht energji elektrike dhe energji termike. Biomasa është një burim i cili na rrethon kudo duke nisur që nga mbetjet e ekonomisë pyjore, në bujqësi, akuakulturë, etj.; me pak fjalë kudo në jetën tonë të përditëshme. Përcaktuesi themelor i produktivitetit të biomasës është sasia e dritës së diellit që bie mbi gjethet e bimës. Aftësia e bimës për të përdorur këtë burim ndërmjetësohet nga temperatura, disponueshmëria e ujit dhe lëndëve ushqyese, lloji dhe speciet e bimëve si dhe aftësia e tyre për t'u përballur me dëmtuesit dhe sëmundjet. Bimët thithin rrezatimin aktiv fotosintetikisht (PAR) në gjatësi vale nga 400-700 nm. PAR përfaqëson afërsisht 50% të energjisë së totalit të energjisë rrezatuese hyrëse. Përveç disponueshmërisë së ujit, temperatura është e një rëndësie kryesore pasi ajo rregullon gjatësinë e sezonit të rritjes. Vendi ynë me një klimë mjaft favorizuese dhe me një sasi orësh me diell të konsiderueshme ofron kushte mjaft të mira për zhvillim e biomasës. Nga ana tjetër si një vend me fokus bujqësinë sasia e biomasës së mundshme për përdorim prodhimi energjie është lehtësisht e disponueshme. Periudha e vjeshtës mund të konsiderohet dhe si një sezon i bollshëm me lëndë bazë për prodhim energjie nga biomasa. Energjia nga biomasa luan një rol të madh në rritjen e sistemit global të energjisë, ndaj menazhimi i një trajektoreje efektive për bioenergjinë intensive kërkon një sërë politikash dhe stimuljesh që të inkurajojnë investitorët për zhvillimin e kësaj industrie.



Renewable energies.

Biomass is basically a conserved source of solar energy which is initially collected by plants during the process of photosynthesis, where carbon dioxide is captured and converted into plant materials mainly in the form of cellulose, semi-cellulose and lignin. Biomass is the raw material from which we can obtain both electricity and thermal energy. Biomass is a resource that surrounds us everywhere starting from the remnants of the forest economy, in agriculture, aquaculture, etc. everywhere in our daily lives. The basic determinant of biomass productivity is the amount of sunlight that falls on the leaves of the plant. The plant's ability to use this resource is mediated by temperature, water and nutrient availability, plant type and species as well as the plant's ability to withstand pests and diseases. Plants absorb photosynthetically active radiation (PAR) in the wavelengths from 400-700 nm. PAR represents roughly 50% of the energy of the total incoming radiative energy. In addition to water availability, temperature is of major importance as it regulates the length of the growing season. Our country with a very favorable climate and a considerable number of hours of sunshine offers very good conditions for biomass development. On the other hand, as a country with a focus on agriculture the amount of potential biomass for energy production use is readily available. The autumn period can also be considered as an abundant season with base materials for biomass energy production.



Energy from biomass plays a large and growing role in the global energy system. Managing an effective trajectory for land-intensive bioenergy will

require an unusual mix of policies and incentives that encourage appropriate utilization in the short term but minimize lock-in in the longer term for investors.

Ndryshimet Klimatike - janë një tematikë mjaft e njohur dhe trajtuar gjerësisht në vitet e fundit kudo në botë dhe në vendin tonë. Le ti referohemi fakteve dhe shifrave dhe gjithësecili mund të gjykojë me drejtë me pas mbi atë çka është vërtetuar e po vërtetohet në ecimin e elementeve kryesore meteorologjike temperature dhe reshje.



Climate Change - is a very well-known topic and widely addressed in recent years everywhere in the world and in our country. Let us refer to the facts and figures and everyone can judge right afterwards on what has been observed and is being observed in the performance of the main meteorological element's temperature and precipitation.

Fillimisht pasqyrohet situata në shkallë kontinentale për reshjet vjetore dhe ato që i përkasin stinës së verës.

Initially reflects the situation on a continental scale for annual rainfall and those belonging to the summer season




Figura Nr.37. – Tendencat në lidhje me reshjet vjetore (majtas) gjatë periudhës 1960 deri në vitin 2015 dhe ato që i përkasin stinës së verës (djathtas). / Trends in annual (left) and summer precipitation across Europe between 1960 and 2015.

Simulimet e modeleve janë bazuar në mesataren e terësisë së shumë modeleve referuar simulimeve të RCM nga iniciativa e EURO-CORDEX.

Model simulations are based on the multi-model ensemble average of RCM simulations from the EURO-CORDEX initiative.

Reshjet vjetore që nga viti 1960 tregojnë një tendencë në rritje deri në 70 mm në dekadë në Evropën verilindore dhe veriperëndimore, dhe një rënie deri në 90 mm në dekadë në disa pjesë të Evropës Jugore. Në gjerësitë e mesme gjeografike nuk janë vërejtur ndryshime të rëndësishme në reshjet vjetore. Reshjet mesatare të verës janë ulur ndjeshëm deri në 20 mm në dekadë në pjesën më të madhe të Evropës Jugore, ndërsa rritje të konsiderueshme deri në 18 mm në dekadë janë regjistruar në pjesë të Evropës veriore.

Annual precipitation since 1960 shows an increasing trend of up to 70 mm per decade in north-eastern and north-western Europe, and a decrease of up to 90 mm per decade in some parts of southern Europe. At mid-latitudes no significant changes in annual precipitation have been observed. Mean summer precipitation has significantly decreased by up to 20 mm per decade in most of southern Europe, while significant increases of up to 18 mm per decade have been recorded in parts of northern Europe.

Ndryshimet e parashikuara në reshjet ndryshojnë ndjeshëm sipas rajoneve dhe stinëve. Reshjet vjetore përgjithësisht parashikohen të rriten në Evropën veriore dhe të zvogëlohen në Evropën Jugore. Rënia e parashikuar në Evropën Jugore është më e fortë në verë.

